



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo




Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021659-4/25, dt. 28.04.2025

Mitrovicë



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 17, pika j dhe m, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 59, paragrafi 2, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenit 3, paragrafi 4, të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 28.04.2025, pasi shqyrtoi Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës Nr. 01-400/04-0021015/25 dt. 11.04.2025, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0021658-2/25 dt. 25.04.2025), sjellë: sjell këtë:

VENDIM

Për miratimin e Kërkesës së Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për ndarjen e mjeteve buxhetore

1. MIRATOHET Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 5,000.00 €, (pesëmijë euro) si mbështetje financiare.
2. Mjetet financiare të ndara sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës do t'i shërbejnë për aktivitete sindikale në interes të të punësuarve në Komunën e Mitrovicës.
3. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere dhe derdhen në llogarinë bankare të Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës, respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për Buxhet dhe Financa